



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

i mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 30.11.2023, duke filluar në orën 8:30.

Në mbledhje morën pjesë: Pëllumb Bajçinovci, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri, Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Bahri Gashi dhe Mirsad Vitia.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Osman Bllaca, Valbona Ahmeti – Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave, Ilirik Musliu – drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve publike, Seniha Bajraktari – zyrtare e Drejtorisë së Shërbimeve publike, Besnik Bllaca, -zyrtar i Drejtorisë së Shërbimeve publike, Doruntinë Maloku- drejtore e Drejtorisë së Pronës, Florian Dushi - drejtor i Drejtorisë së Inspektionit, Mimoza Sylejmani – drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiki - drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Florim Krasniqi,- përfaqësues nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Arben Kqira – Shef i Zyrës ligjore.

Kryesuesi: - tha, para se të fillojmë me mbledhjen e KPF – së fjalën ja jap kryetarit Përparim Rama.

Përparim Rama:- i përshëndeti të pranishmit, tha se kanë vendosur me sjell në rend të ditës një pikë Planin Rregullativ të "Kalabrisë" dhe ideja për me sjell sot eshtë për me filluar procesin e shqyrtimit publik se kemi presion të madh prej qytetarëve të "Kalabrisë" për të sjellë në diskutim publik, nuk eshtë një vendim final i "Kalabrisë", por diskutim publik. Fokusi në Kalabri eshtë ngritja e vlerës së pronave komunale sepse problemet që i kemi sot me nivelin qendror eshtë që ne nuk po kemi mundësi të varemi prej tyre për investimet e mëdha kapitale si p.sh. unaza e qytetit, ndërlidhjen te Gorenja, etj. Kemi pasur një mundësi në Kalabri që pronat si komunë, Kryeqytet që i kemi në pronësi për me pas një mundësi shtesë ku ne mund t'i thërrasim investorët nga Jashtë përmes kompanive tona si NPB, p.sh. e dedikuar për zhvillim të kryeqytetit mund të bëjmë kontrata të ndryshme. Po ashtu e kemi edhe pikën që Qeveria e mëparshme e ka votuar në Kalabri që çdo koeficient që ka qenë 1.8 të bëhet 2.4 dhe këtë e kemi respektuar se e kemi premtuar. Po ashtu po e organizojmë konferencën për investime 23-25 janar ku edhe si pjesë e saj kemi një numër të madh të bankave vendore dhe ndërkombëtare që janë të interesuara për të ardhur, oda të ndryshme si e Zvicrës, Turqisë e të tjera, të cilat janë të interesuara të vijnë për t'na vizituar për potenciale të investimeve në kryeqytet dhe me këto elemente po e shfrytëzojmë rastin që këto zona qendrore me pas mundësi me ndërlidh një zhvillim në një anë, me një zhvillim në anën tjetër me investimet kapitale.

Faqe1nga8

Po ashtu pika tjera janë edhe rregulloret të rëndësishme për rregullimin e jetës në Kryeqytet faktikisht sistemimin e ndryshëm p.sh. në aspektin e pronës, në aspektin e parkingut "Prishtina Parking", etj që mbesim problem kyç në kryeqytet.

Mimoza Sylejmani: - tha se Florimi si menaxher i grupit punues e ka përgatitur një prezantim për sot për "Kalabrinë" kur të jeni të gatshëm mundemi me prezantuar.

Leutrim Retkoceri: - tha se takimet e KPF-së i mbajmë 2-3 ditë para seancave ashtu siç e kërkon Ligji për Qeverisjen Lokale, mirëpo qe dy herë janë duke u mbajt takimet e KPF-së të njëjtën ditë të seancës, kurse kjo që është praktikë e re e cila nuk ka qenë më herët dhe kjo na kufizon për materiale që minden me pas qasje qoftë grupet apo asamblistët në to, kështu që është mirë si qasje me qenë korrektë dhe me kohë ashtu siç e kërkon ligji që thotë 7 ditë duhet me qenë materiali para mbledhjes së KPF-së, dhe është mundësia në KPF me u fut pika të reja të ditës, mirëpo së paku me pas kohë dy ditë përpëra për t'i shqyrta materialet.

Sa i përket çështjes së " Kalabrisë" janë dy vite që çështja është duke u diskutuar, ndërkaq ne për pika të rendit të ditës duhet me ndjek një parim që së paku dy ditë më herët me pas materialin.

Përparim Rama:- tha me rëndësi me kuptuar të gjithë asamblistët se ne çka po propozojmë, unë i ceka tri pikat kyç që janë në planin e "Kalabrisë" - një është me mbajt qëndrimin që çdo koeficient që ka qenë 1.8 të bëhet 2.4., - e dyta është me ngrit vlerën e tokave të Komunës dhe e - treta t'i rishqyrtojmë këto rrugë, p.sh që kanë qenë më të ngushta, t'i zgjerojmë dhe t'i bëjmë lidhjet me këto gjelbërimet.

Leutrim Retkoceri:- tha është mirë asamblistëve me ju dërguar materialet tri ditë më herët dhe ata me ditë çka është duke u bërë, me shkuar me procedurë dhe e kalojmë pa asnijë problem.

Kryesuesi: - tha, në bazë të informatave edhe nga Zyra ligjore dhe nga ju për interpretimin e pikës sigurisht nevoja për të reviduar dhe kërkesa të mëdha të komunitetit që jetojnë aty, siç po e kuptojmë ne këtu në KPF, ky nuk është një plan final, por është një draft dhe gjatë diskutimit publik do të ketë ndoshta edhe propozime dhe sugjerime nga banorët që aty jetojnë dhe ato do të inkorporohen dhe do të vazhdojnë procedurat tutje.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Pëllumb Bajçinovci - kryesues i komitetit, me këtë:

REND DITE

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë e Financa;**
- 2. Projektrregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës;**
- 3. Projektrregullorja për menaxhimin e mbeturinave dhe Plani komunal i menaxhimit të mbeturinave 2023-2027;**
- 4. Propozimrregullorja për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhëni në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një vit;**
- 5. Propozimrregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores mbi taksën administrative për dhëni e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, 01-434/01-0094474/17, dt.24.04.2017;**
- 6. Propozim – vendimi për caktimin e shkallës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024;**
- 7. Propozim – vendimi për heqjen e taksës për vulën në transaksion;**
- 8. Propozim – vendimi lidhur me Planin e integritetit në Kryeqytetin Prishtinë 2023-2026;**
- 9. Propozim – vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për cilësinë e ajrit në Komunën e Prishtinës 2023-2027.**

Faqe2nga8

- 10. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Reportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2022;**
- 11. Të ndryshme.**

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, **Valbona Makolli** propozoi që të futet si pikë re rendit të ditës “**Vendimi për faljen e tatimit në pronë të paluajtshme për vitin tatimor 2023**”.

Përparim Rama:- kryetari i kryeqytetit propozoi që nëse nuk dëshirojnë që të futen pika të reja në rend dite, ne mundemi deri më 8 dhjetor të mbajmë ndonjë seancë të jashtëzakonshme dhe të votojmë këtë çështje.

Alban Zogaj:- nënkyetar i kryeqytetit tha ne i kemi pasur disa konsulta të brendshme, e pamë se ka nevojë edhe për disa konsultime me partnerët tanë dhe me të gjithë, kështu që të mbetet për ndonjë mbledhje tjetër të jashtëzakonshme vetëm për këtë pikë.

Kryesuesi:- konstatoi se anëtarët e komitetit u pajtuan që të mbetet kjo pikë për një seancë tjetër.

Mimoza Sylejmani:- propozoi që të futet si pikë e re e rendit të ditës “**Lënia në shqyrtim publik për projektdokumentin për planin rregullues të hollësishëm Kalabria 2023-2031 në Prishtinë**”.

Jeta Rafuna: - tha sa i përket kësaj pike për shqyrtimin e Kalabrisë është pikë që e mirëpresim, duke pas parasysh presionin e banorëve, por është vonë, është dashur të kemi materialin me kohë, mirëpo ne do ta përkrahim këtë pikë dhe do ta votojmë.

Leutrim Retkoceri:- tha se janë dakord të votojnë për lënien në shqyrtim publik për Kalabrinë në momentin që e kanë materialin në një seancë të rregullt apo të jashtëzakonshme.

Kryesuesi:- konstatoi se anëtarët e komitetit u pajtuan që të mbetet kjo pikë për një seancë tjetër.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë e Financa

Kryesuesi konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit i mbledhjes së tetë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Projektrregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës

Florian Dushi:- tha s'ka diçka që teknikisht është përmirësuar apo dizajni dhe vetëm një ndryshim e kemi në formulim te Personat me nevoja të veçanta sepse ka qenë një formulim krejt i paqartë, përndryshe nuk ka diçka që ndryshon prej herës së kaluar.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Projektrregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tretë

Projektrregullorja për menaxhimin e mbeturinave dhe Plani komunal i menaxhimit të mbeturinave 2023-2027

Seniha Bajraktari:- tha në mbledhjen e kaluar kam qenë prezent dhe kur është diskutuar kjo rregullore janë kërkuar disa ndryshime në dizajn të rregullores, pyetjeve të parashtuara prej anëtarëve të komiteit lidhur me ndryshimet e çmimeve dhe shërbimin lidhur me planin e veprimit ju jemi përgjigjur, kështu që besoj se ndryshimet janë bërë në bazë të kërkësave të parashtuara për këtë rregullore.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Projektrregullorja për menaxhimin e mbeturinave dhe Plani komunal i menaxhimit të mbeturinave 2023-2027 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozimrregullorja për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një vit

Doruntinë Maloku:- tha në lidhje me këtë rregullore nga mbledhja e kaluar e KPF-së ajo që ekzekutivi ka ndryshuar në bazë të vërejtjeve që kemi marrë është që në nenin 17 kemi shtuar shtojcën e dytë në bazë të së cilës d.m.th do të përcaktohen hapësirat publike që do të lëshohen për shfrytëzim në bazë të kompetencave që ka Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe kjo lidhet me dispozitat shfuqizuese për nenin 18 ku e kemi shfuqizuar rregulloren që herën e kaluar e ka prezantuar drejtori Ilirik.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimrregullorja për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një vit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozimrregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, 01-434/01-0094474/17, dt. 24.04.2017

Arbër Sadiki:- tha në parim qëllimi i plotësimit ka të bëjë me moseficiencën e pagesave që ka qenë deri tash për shkak të atyre kësteve që praktika ka qenë që me pagesën e këstít të parë ju është lëshuar leje ndërtimore e pastaj nuk kanë qenë të rregullt investorët për t'i paguar këstet tjera, si rjedhojë ju e dini në mbledhjen e parë kemi kërkuar mekanizma për me mbledh e që kanë qenë rreth 7 milionë dhe kjo për të mosvazduar një praktikë e tillë dhe në këtë rast kemi menduar të diskutojmë që mos të jetë barrë për qytetarin.

Përparim Rama: - dha sqarime shtesë.

Leutrim Retkoceri:- tha borxhi aktual ky që është d.m.th para rregullores, para vendimit, a është i përballueshëm pastaj a jo.

Arbër Sadiki:- dha sqarime për pyetjen e parashtuar nga parafolësi.

Leutrim Retkoceri:- tha kryetari një problematikë që është në qytet a mundet me u inkorporo edhe në këtë vendim, qytetarët janë në hall me mungesë të fletës poseduese të banesave dhe ajo nuk është duke u lëshuar për shkak të pranimit teknik dhe procedurave tjera, andaj nëse gjendet ndonjë mekanizëm që i kushtëzon që kushdo që ndërton tëmund të bëhet pranim - dorëzimi i banesës bashkë me fletën poseduese kishë qenë ideale, pse nuk po e zgjidhni këtë problem.

Përparim Rama:- tha rregullat jonë të tillë që ligji thotë mos t'i lejojmë njerëzit me hy brenda në ndërtesa pa qenë pranimi teknik, andaj ne duhet t'ju përbahemi rregullave.

Shkëmb Manaj:- dha sqarime shtesë lidhur me këtë rregullore duke cekur se gjysma e borxhit është dërguar në komision që ka punuar një vit dhe kemi arritur që pjesën e përmbarimit që kanë qenë dy vitet e fundit e që ka qenë në procedurën e përmbarimit kanë qenë rreth 1.7 milion euro dhe është bërë një veprim i mirë se nëse i kish kaluar afati dhe nuk kishim mundur me i përmbaruar ato dhe me ii arkëtuar. Pjesa tjetër është një pjesë e borxhit që i ka mbi 10 vjet dhe është pak problematike sepse është periudhë që Komuna e Prishtinës aq sa mundet të bëjë padi t'i tërhiq, por janë duke i shikuar disa mekanizma që t'i bëjnë disa ndalesa aq sa na lejon ligji në mënyrë që m'i obliguar investitorët të bëjnë pagesat e borxheve nëse dëshirojnë ata me marrë leje të reja, duke shtuar se i kemi disa pengesa ligjore dhe jemi duke gjetur forma, mekanizma në mënyrë që ata m'i obliguar, një pjesë e investitorëve kanë pranuar që me hy në marrëveshje të re që edhe na edhe me anë të padisë nuk kishim mundur m'i tërheq këto borxhe, kështu që kanë pranuar të hyjnë në marrëveshje për t'i kryer këto borxhe. Kryetari së shpejti do t'i takojë të gjithë këta investitorë vetëm jemi duke i shikuar formën se a dëshirojmë me i takuar në grup investitorët që kanë borxh ndaj Komunës së Prishtinës apo me i takuar një nga një. Komisioni i ka takuar të gjithë e tani i kemi të dhënët për secilin investor që ka borxhe dhe ku është problemi që nuk e kanë paguar një borxh.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimrregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, 01-434/01-0094474/17, dt.24.04.2017 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozim –vendimi për caktimin e shkallës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024

Valbona Makolli:- tha lidhur me këtë propozim –vendim i kemi arsyetimet dhe gjitha vendimet e Ministrisë së Financave, ku si ministri që është e obliguar që çdo tri vjet e bën vlerësimin e pronave të të gjitha komunave edhe komunës tonë, në bazë të raporteve të cilave i kemi marrë nga MF –ve i kemi përcaktuar edhe normat tatimore për këto kategori të cekura në material.

Leutrim Retkoceri :- pyeti se çfarë rekomandime ka dhënë inismtria në bazë të Ligjit përfaljen e tatimit për pronë dhe të atyre që kanë pronën me vlerën jo më të madhe se 30 mijë €, a është i inkorporuar në vendim.

Valbona Makolli:- dha sqarime në pyetjen e parashtruar nga parafolësi.

Leutrim Retkoceri :- tha këtu me plotësi- ndryshimin e Ligjit që është bërë tash për çështjen e faljeve, ata komunave ju kanë vënë dy gjëra: faljen që me marrë për bazë për aspektin për me irritë buxhetin me vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe e dyta, ata me ligj ta kanë lënë një mundësi ku thotë: në të gjitha objektet që kanë vlerën nën 30 mijë €, ti mundesh me i fal komplet, me i liruar prej tatimit, është mirë ta bëjmë të qartë këtë vendim, a përfshihet a jo dhe është mirë ne me pas një tabelë krahasuese me vlerësimin që ka qenë përparrë të dihet saktë dhe të sqarohet.

Përparim Rama:- tha në aspektin e taksës në pronë, ne e kemi pas këtë diskutim tash para një viti ku kemi propozuar me ngri taksën për këtë vit edhe se kemi fajësuar Qeverinë që e ka ngrit, neve si kryeqytet na vyen taksa në pronë për zhvillim të kryeqytetit, ne nuk kemi mundësi me fal se falja e taksës në pronë na shkon në dëm të zhvillimit të kryeqytetit, por kemi mundësi për me ngri. Me propozimin e ri të Qeverisë ku thotë caktoni ju sa dëshironi me ju fal prej 0-100, ku çka na po themi që ne po e falim diferençën d.m.th ne nuk po falim prej buxhetit qysh e kemi pas deri tani, por rritjen prej 0-100 pra vetëm diferençën që na lejohet. Propozimi jonë është na e falim ndryshimin në rritje prej 0-100, kjo nuk na dëmton buxhetin, kjo ju

ndihmon qytetarëve dhe anën tjetër na ndihmon prapë se një pjesë ngritet, marrim fonde shtesë që na ndihmojnë pastaj me ndërtuar shkolla, çerdhe rrugë etj.

Leutrim Retkoceri :- pyeti a përfshihet edhe kamata për këtë kohën që e kemi ngri që qytetarët nuk kanë paguar, a përfshihet edhe kjo në falje.

Valbona Makollı:- tha nuk është e cekur kamata.

Milazim Vitija:- tha te shkalla tatimore te njësitetë pyjore të hapësirave që është 0.15 që është e barabartë me objektet rezidenciale, po më duket është pak e lartë.

Valbona Makollı :- dha sqarime në pyetjen e parashtruar nga parafolësi.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim – vendimi për caktimin e shkallës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozim – vendimi për heqjen e taksës për vulën në transaksion

Valbona Makollı:- dha sqarime lidhur me **Propozim –vendimin për heqjen e taksës për vulën në transaksion** duke cekur se ka qenë një vendim i Kuvendit i ardhur si propozim për një vit d.m.th. afati është deri në fund të vitit 2023, mirëpo ne e kemi pa të arsyeshme se mbledhja e fundit për me dërguar në ministri është pak vonë, kurse për ligshmëri i kemi bërë analizat, e kemi dhënë arsyeshmërinë pse e përkrahim me hjek krejt dhe kemi treguar se me këtë vendim cilat rregullore shfuqizohen, janë bashkëngjit materialet.

Milazim Vitija:- tha sa i përket taksës në transaksion, pajtohem plotësisht që të shfuqizohet neni 4 i taksës në transaksion.

Përparim Rama:- tha kjo ndërlidhet tani edhe me ndryshimin e disa ligjeve, kjo puna e transaksioneve.

Valbona Makollı:- tha e ka lehtesar shumë kryetar, vetëm për periudhën janar-qershori 2023 janë proceduar 4123 kërkesa për bartje që i bie 63% kanë aplikuar.

Përparim Rama:- tha ideja ka qenë na me suspenduar për një vit, faktikisht me i stimuluar krejt qytetarët që kanë me kryer punë, që punët t'i kryejnë brenda një viti mos t'i lënë për vitin e ardhshëm.

Shkëmb Manaj:- dha sqarime shtesë duke cekur se me hulumtimin e fundit që e ka bërë Avokati i popullit ka konsideruar se është një taksë e dyfishtë, kështu që të hiqet krejt taksa për transaksion, tani ka taksë në bartje të pronës, por nuk ka taksë në transaksion që ka qenë pagesë në bartjen e pronave dhe ka qenë ngarkesë e madhe për qytetarët.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim – vendimi për heqjen e taksës për vulën në transaksion dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Propozim –vendimi lidhur me Planin e integritetit në Kryeqytetin Prishtinë 2023-2026

Osman Bllaca:- tha se Planin e integritetit e kemi për obligim për me hartuar në bazë të ligjit i cili është për Agjencinë Kundër Korrupsionit për parandalimin e korrrupsionit dhe na obligon që komunat të hartojnë një Plan të integritetit duke u bazuar në një plan strategjik i cili është hartuar për luftimin e korrrupsionit dhe ngritjen e integritetit në nivel të vendit 2021-2023. Kryeqyteti e ka hartuar planin ku koordinator ka qenë një person i cili tani nuk është pjesë e komunës, ku realisht me ligj kryetari e ka pa të rrugës dhe interes pasi që përfshihen gjitha drejtoritë, që ta sjell në Kuvend, mirëpo kryetari e ka pa të rrugës dhe interes pasi që përfshihen gjitha drejtoritë, që ta sjell në Kuvend. Sa i përket koordinatorit po ashtu shumë shpejt do të

Faqe6nga8

vendoset edhe koordinatori i Planit të integritetit ashtu siç e parashev edhe ligji që duhet të jetë që pastaj duhet të përcjellë komplet planin dhe do të raportojë edhe në Agjencinë për parandalimin e korruptionit.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim –vendimi lidhur me Planin e integritetit në Kryeqytetin Prishtinë 2023-2026 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e nëntë

Propozim – vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për cilësinë e ajrit në Komunën e Prishtinës 2023-2027

Seniha Bajraktari:- tha se dokumenti Plani lokal i veprimit për cilësinë e ajrit është obligim për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës e në veçanti për Komunën e Prishtinës për shkak se ka qenë kërkesë e Komisionit Evropian prej vitit 2019 që të ketë një Plan për cilësinë e ajrit në Komunën e Prishtinës. Këtë dokument e ka hartuar një OJQ, dokumenti ka filluar prej vitit 2021, ka qenë një komision prej 6 anëtarëve, i përbërë nga: përfaqësuesi i komunës, Institutit hidrometeorologjik, i planifikimit hapësinor dhe Universitetit të Prishtinës. Dokumenti i ka kaluar të gjitha fazat dhe është i gatshëm për herën e fundit, e kam raportuar para dy jave, kam thënë se në mbledhjen e nëntorit do të aprovohet në Kuvend, përndryshe të gjitha procedurat i ke. Po ashtu kërkoi që ky dokument duhet të ketë një kordinator se çdo 3 muaj duhet raportuar në Komisionin Evropian lidhur me implementin e projektit. Njëherazi kërkoi nga kryetari që nëse ka mundësi për një falënderim ose një mirënjojje për hartuesit e dokumentit pasi të miratohet në Kuvend.

Përparim Rama:-u pajtua se do të gjejë kohë pët t'u takuar me grupin dhe për t'i falënderuar.

Kryesuesi:- tha sa i përket kërkesës për koordinator, sigurisht duhet të jetë koordinatori me vendim të kryetarit sikurse në propozim- vendimin për Planin e integritetit, pra koordinatorët do të përzgjidhen nga kryetari me vendim.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim – vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për cilësinë e ajrit në Komunën e Prishtinës 2023-2027 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dhjetë

Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2022

Osman Bllaca:- tha se e kanë hartuar raportin periodik, zbatimin e rekomandimeve të cilat kanë dalë prej Zyrës Kombëtare e Auditimit, ku kemi pasur 22 rekomandime e të cilat kanë ardhur prej Zyrës kombëtare ku deri tani janë implementuar 8 rekomandime të cilat janë të implementuara tërsisht 10 të tjerat janë në proces dhe 40 rekomandime janë të paimplementuara. Po ashtu i kemi edhe 2 prej rekomandimeve të cilat do t'i shohim se çka do të mund të bëjmë pasi t'i hartojmë pasqyrat financiare vjetore të cilat i kemi për obligim t'i hartojmë gjatë janarit 2024. Deri tani është i papërmirësueshëm procesi i dhënies në leje i kushteve të ndërtimit dhe lejeve të ndërtimit që është atje një afat që Ligji për Ndërtim i paraparë prej 30 ditëve dhe 45 ditë pajisje për leje dhe ai afat kohor nuk mund të realizohet për arsy se një zyrtar është i ngarkuar me 30 lëndë.

Përparim Rama: - tha se parashihet me ju kthyer përgjigje brenda 30 ditëve jo të aprovohet.

Osman Bllaca:- tha se duhet të rritet numri i zyrtarëve se nuk mundet një zyrtar se ka shumë lëndë, nëse është një trend i kërkesave siç janë duke ardhur kërkesat për leje ndërtimi.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2022 dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

Të ndryshme

Milazim Vitija: - kërkoi nga kryesuesi që gjatë seancës t'i përbahemi Rregullores së Kuvendit, ku për një pikë të rendit të ditës kemi drejt të gjithë të diskutojmë njëherë, nëse i përmendet emri, replika 1 minutë jo për një pikë të rendit të ditës me diskutuar disa herë, kurse shefat e grupeve parlamentare i kanë nga 10 minuta, e ne të tjerët nga 5 , kështu që rregullorja të zbatohet si në Kuvend si në KPF.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

**Procesmbajtësja
Shyhrete Islami**



Faqe 8 nga 8